

VENDIM
Nr. 284, datë 17.12.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MËNYRËN E
KOMPENSIMIT PËR ORËT SHITESË TË PUNËS TË KRYERA NGA
NËPUNËSIT CIVILË TË PROKURORISË”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenin 149/a, të Kushtetutës, në nenin 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, në nenin 84, pika 4, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, dhe në pikën 5, kreu I, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 13.11.2019, “Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, ditët pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë”,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për mënyrën e kompensimit për orët shtesë të kryera nga nëpunësit civilë të prokurorisë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Ibrahimi

RREGULLORE
**PËR MËNYRËN E KOMPENSIMIT PËR ORËT SHITESË TË PUNËS TË KRYERA
NGA NËPUNËSIT CIVILË TË PROKURORISË**

Neni 1
Objekti

Rregullorja, për mënyrën e kompensimit për orët shtesë të kryera jashtë orarit zyrtar të punës nga nëpunësit civilë të prokurorisë (në vijim “rregullorja”), vendos rregulla të detajuara për kompensimin me pushim dhe, në rast pamundësie, për kompensimin financiar që duhet të marrin sipas ligjit nëpunësit civilë të prokurorisë, që kryejnë orë shtesë jashtë orarit zyrtar të punës, në ditët e pushimit dhe të festave zyrtare, për shkak të shërbimit të gatishmërisë së prokurorëve, masave të sigurimit dhe çdo rasti tjetër që kërkon domosdoshmërinë e angazhimit në punë të nëpunësve civilë të prokurorisë, që buron nga parashikimet e Kodit të Procedurës Penale, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ligjeve të tjera.

Neni 2
Qëllimi

Rregullorja ka si qëllim të plotësojë kuadrin ligjor të nevojshëm për të garantuar kompensimin e orëve shtesë të punës të kryera jashtë orarit zyrtar të punës, në ditët e pushimit dhe të festave zyrtare, në një nga format e parashikuara nga ligji.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore bazohet në nenin 70 dhe në shkronjën “b”, të pikës 4, të nenit 84, të ligjit nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 91, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 17, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 13.11.2019, “Për rregullat për kohëzgjatjen e punës, ditët pushim dhe lejen, orët jashtë orarit dhe shpërblimin e tyre, si dhe kompensimin e shpenzimeve për kryerjen e detyrës jashtë vendit të punës për nëpunësit civilë gjyqësorë dhe të prokurorisë”.

Neni 4
Subjektet

Subjekt i kësaj rregulloreje janë nëpunësit civilë në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore, si dhe strukturave organike përkatëse.

Neni 5
Parimi i barazisë

Kjo rregullore mbështetet në parimin e barazisë, sipas së cilit, nëpunësit civilë të prokurorisë kanë të drejtën e kompensimit për orët shtesë të punës të kryera jashtë orarit zyrtar, në ditët e pushimit dhe të festave zyrtare.

Neni 6
Orët shtesë të punës

1. Konsiderohen orë shtesë të punës orët e kryera jashtë orarit zyrtar ditor të punës, në ditët e pushimit dhe të festave zyrtare, sipas përcaktimeve të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Kohëzgjatja ditore normale e punës konsiderohet jo më shumë se 8 orë.
3. Konsiderohen punë e kryer gjatë orarit zyrtar, puna e kryer nga ora 08:00 deri në orën 16:00.
4. Në çdo rast, orët shtesë nuk duhet të tejkalojë më shumë se 200 orë në vit për çdo nëpunës civil të prokurorisë.

Neni 7
Dokumentimi i orëve shtesë

Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin me shkrim të drejtuesit të prokurorisë, nëpunësit mund t'i kërkojë të kryejë orë shtesë.

Eprori i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil të prokurorisë konfirmon numrin e orëve shtesë të kryera, si dhe kohën e kryerjes së tyre nëpërmjet një dokumenti (raporti) provues ku pasqyrohen orët shtesë të kryera.

Neni 8
Mënyra e kompensimit

1. Nëpunësit civilë të prokurorisë që ushtrojnë detyrën e tyre jashtë orarit zyrtar, në ditët e pushimit dhe të festave zyrtare përfitojnë kompensim me pushim dhe, kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, ata kanë të drejtë të kompensohen financiarisht, me të holla (lek) mbi pagën normale të tyre.

2. Për çdo orë shtesë të kryer, nëpunësit civilë të prokurorisë duhet të kompensohen me pushim të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur orët shtesë janë realizuar në ditë normale pune.

3. Për çdo orë shtesë të kryer, nëpunësit civilë të prokurorisë duhet të kompensohet me pushim të barabartë me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët shtesë janë realizuar në ditë pushimi, ditë feste zyrtare apo nga ora 22:00–06:00 në ditët normale të punës.

4. Nëpunësit civilë të prokurorisë kompensohen për çdo orë shtesë të kryer me pushim, sipas përcaktimeve të pikave 2 dhe 3 të këtij neni, brenda 6 muajve nga dita e kryerjes së punës.

5. Në raste të veçanta, kur është e pamundur kompensimi me pushim për orët shtesë, sipas pikës 4, të këtij neni, nëpunësit civilë të prokurorisë kanë të drejtë të kompensohen financiarisht.

6. Nëpunësit civilë të prokurorisë duhet kompensohen financiarisht për orët shtesë të punës me jo më pak se 25% më shumë mbi vlerën, për çdo orë shtesë të kryer në ditët normale të punës.

7. Nëpunësit civilë të prokurorisë duhet kompensohen financiarisht për orët shtesë të punës me jo më pak se 50% më shumë mbi vlerën, për çdo orë shtesë të kryer gjatë pushimit javor, në ditët e festave zyrtare apo nga ora 22:00–06:00, në ditët normale të punës.

8. Drejtuesi i prokurorisë duhet të planifikojë kompensimin me pushim brenda afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni. Në rast pamundësie për kompensim me pushim si më sipër, ai harton një raport të veçantë, ku argumenton pamundësinë për kompensimin e orëve shtesë me pushim.

9. Kërkesa e eprorit të drejtpërdrejtë për kryerjen e orëve shtesë, miratimi me shkrim i drejtuesit të prokurorisë, dokumenti (raporti) provues ku pasqyrohen orët shtesë të kryera dhe, sipas rastit, edhe raporti i veçantë ku është argumentuar pamundësia për kompensimin e orëve shtesë me pushim, shoqërojnë kërkesën e drejtuesit të prokurorisë për ekzekutimin e kompensimit financiar nga institucioni përgjegjës.

10. Kompensimi financiar, për çdo orë shtesë të kryer jashtë orarit zyrtar, në ditët e pushimit dhe të festave zyrtare, do të planifikohet si shpenzim në buxhetin e vitit pasardhës të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, vetëm në rast se kompensimi financiar, sipas kësaj rregulloreje, nuk mund të realizohet nga fondi i pagave i mbetur pa u ezauruar në vitin aktual në të cilin janë kryer orët shtesë.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË